

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 831 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 129, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi *Kërkesën për ndryshim të vendimit të KKA Nr. 84 datë 22.06.2016*, në lidhje me kryerjen nga ASHA të një sondazhi arkeologjik, në vendin e parashikuar për ndërtimin e antenës në fshatin Gjuzaj të Elbasanit, pasi paraqesim propozimin për spostimin e vendndodhjes së kësaj antene në një pozicion të përshtatshëm. të përcaktuar nga verifikimi në terren i specialistëve të ASHA dhe RTSH, paraqitur nga RTSH,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e paraqitur nga RTSH, për spostimin e vendndodhjes së antenës në fshatin Gjuzaj të Elbasanit, në pozicionin e përcaktuar nga verifikimi në terren i specialistëve të ASHA dhe RTSH.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO